

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                                                                                         |
|---------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | 12 orë debat/ Nga KAYO te miratimi i drafti për pagat e magjistratëve, çfarë ndodhi në seancën maraton ë në Kuvend                                                                                                                      |
| ADRESA  | <a href="https://piranjat.al/politike/12-ore-debat-nga-kayo-te-miratimi-i-drafti-per-pagat-e-magjistrateve-cf-i104778">https://piranjat.al/politike/12-ore-debat-nga-kayo-te-miratimi-i-drafti-per-pagat-e-magjistrateve-cf-i104778</a> |
| BURIMI  | piranjat.al                                                                                                                                                                                                                             |
| GJENDJA | online                                                                                                                                                                                                                                  |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 18 shtator 2026, 07:33:52 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 18 shtator 2026, 07:19:45 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | 85e27a75339e9340e31f2fa0e5d287f5daca0ca130b1f218ee7633e1161ea23  |
| TEKSTI     | bdc323b73bfb4a254c7ce9ed2b3bb0474772ae45242d0de6f94986da386f2de8 |
| PAMJA      | cbdd9f40b937237d8feb39b9a9475c2933f8cbf18cd9dab74952fd45aff342ad |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | d7e6de9c8051b4b1b59a46aa297aecdfc394903a2d8a8bf8d8b621b9392e5fd6                                |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                               |
| RRËNJA MERKLE | 401dcacf3311c18d7b93cbabfd522e0d009d4ac62bab22fd89058a16395500d64                               |
| ANKORIMI      | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d7e6de9c8051b4b1b59a46aa297aecdfc394903a2d8a8bf8d8b621b9392e5fd6>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px





- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash:

**magjistratëve** shtator  
**çfarë ndodhi** 2026), në  
një seancë

**Frakulla e** ka  
**Madhe:** dërguar  
një

**Tepelena: U**  
**jemi kthyer**

protestuesit  
është e  
papunueshme,

**dukej sikur** se Mbreti  
**kishte** Charles  
"dukej"

**Një cisternë u** anije ciste  
**godit në** me flamur  
Togosi, e c

POLITIKE

## 12 orë debat/ Nga KAYO te miratimi i drafti për pagat e magjistratëve, çfarë ndodhi në seancën maratonë në Kuvend

Piranjat Përditësimi i fundit 18 Shtator 2026, 09:19



Kuvendi u mbledh në seancë plenare ditën e djeshme, (17 shtator 2026), në një seancë maratonë që zgjati më shumë se 12 orë, të shoqëruar me debate e replika mes mazhorancës dhe opozitës.

Në rendin e ditës ishin parashikuar interpelancat me ministra, ndërsa gjatë seancës u diskutuan edhe aktiviteti i kompanisë **KAYO**, zhvillimet pas vendimit të Gjykatës Speciale në Hagë për ish-drejtnesit e **UÇK-së**, si edhe projektligji për **pagat e magjistratëve**. Dy nga pesë interpelancat e parashikuara u shtynë, për shkak të mungesës së ministrit të Mjedisit dhe dorëheqjes së ministrit të Brendshëm.

Që në nisje të ditës, një nga çështjet që shkaktoi përplasje mes mazhorancës dhe opozitës ishte **KAYO**.

Partia Demokratike kërkoi ngritjen e një komisioni hetimor parlamentar për veprimtarinë e kompanisë shtetërore. Kërkesa u rrëzua në Konferencën e Kryetarëve, ndërsa opozita këmbënguli se duhej të hetoheshin aktiviteti i kompanisë, përdorimi i fondeve publike dhe kontratat e lidhura prej saj.

Kreu i Grupit Parlamentar të PD-së, Gazment Bardhi, deklaroi se KAYO kishte shpenzuar, sipas tij, rreth 34 milionë euro nga buxheti i shtetit pa prodhuar ende rezultate të dukshme, dhe kërkoi që këto pretendime të hetoheshin përmes një komisioni parlamentar.

"Çdo komision hetimor ka për qëllim mbledhjen e informacionit. Ndryshe, për çfarë do të duhej komisioni?", deklaroi Bardhi, duke shtuar se opozita kishte paraqitur në kërkesë informacionet dhe indiciet që, sipas saj, justifikonin hetimin.

Nga ana tjetër, kryetari i Grupit Parlamentar të PS-së, Taulant Balla, argumentoi se kërkesa e opozitës nuk plotësonte kriteret kushtetuese dhe ligjore për ngritjen e një komisioni hetimor. Sipas tij,

objekti i propozuar ishte shumë i gjerë dhe nuk përcaktonte një çështje të veçantë që do të hetohej.

*“Kërkesa për ngritjen e një komisioni hetimor parlamentar lidhur me shoqërinë KAYO nuk përmbush kriteret kushtetuese dhe ligjore”, deklaroi Balla, duke kundërshtuar edhe mënyrën se si opozita kishte përcaktuar objektin e hetimit.*

Debat i zhvendos më pas në sallën e Kuvendit, ku deputetja demokrate Jorida Tabaku e përdori çështjen KAYO si shembull të asaj që ajo e konsideroi problem me administrimin e pasurive dhe fondeve publike.

Tabaku ngriti gjithashtu çështjen e përdorimit të fondeve publike, duke deklaruar se 34 milionë euro, sipas saj, ishin përdorur në mënyrë jotransparente për katër kompani që lidhen me zhvillimin e industrisë së mbrojtjes.

*“KAYO tregoi se në Shqipëri nuk ka rëndësi sesa eksperiencë ke, sesi bën biznes, sesa ke investuar, por duhet të njohësh vetëm një njeri, Edi Ramën, për të bërë biznes, për të marrë një kontratë publike dhe për të ecur përpara. Asetet publike ndodhen sot nën sulm nga modeli KAYO dhe modele të tjera të ngjashme”, – u shpreh Tabaku.*

#### Berisha përplaslet me ministren e Shëndetësisë

Një tjetër debat i fortë gjatë seancës ishte ai mes kreut të PD-së, **Sali Berisha**, dhe ministres së re të Shëndetësisë, Klodiana Spahiu.

Berisha lu drejtua ministres duke e lidhur emërimin e saj me dorëheqjen e paraardhëses Evis Sala dhe e kritikoi për marrjen e detyrës.

*“Pararendësja juaj, ajo ka qenë një studiuese e rrallë... me dorëheqjen e saj, ajo mbrojti integritetin e vet”, deklaroi Berisha, ndërsa më tej iu drejtua Spahiut me thirrjen: “Uroj të mbledhësh mendjen dhe të japësh dorëheqjen një minutë e më parë nga ajo detyrë.”*

Ministria, nga ana tjetër, mbrojti vendimin për të marrë detyrën dhe deklaroi se përgjegjësia e saj ishte t’u shërbente qytetarëve.

#### Deklarata e përbashkët për Kosovën

Në vijim të seancës, një tjetër zhvillim ishte deklarata e përbashkët e Kuvendit për vendimin e Gjykatës Speciale në Hagë ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

Deklarata, e lexuar nga kryetari i Kuvendit Niko Peleshi, e cilësoi vendimin të padrejtë dhe ritheksoi rolin historik të UÇK-së në luftën për çlirimim e Kosovës. Në të njëjtën deklaratë, Kuvendi shprehu shqetësimin për standarde që i konsideroi të dyfishta në trajtimin publik të personave të dënuar për krime lufte.

Pas diskutimit të çështjeve të mësipërme, vëmendja e Kuvendit u përqendrua te projektligji i propozuar nga Partia Socialiste për ndryshimin e formulës së pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Projektligji i kundërshtua nga opozita, e cila kërkoi që votimi të shtyhej dhe që të vijonte konsultimi me institucionet e drejtësisë.

Kreu i Grupit Parlamentar të PD-së, Gazment Bardhi, kërkoi që projektligji të hiqej nga rendi i ditës dhe të shqyrtohej më tej në raport me qëndrimet e institucioneve të drejtësisë.

Bardhi e cilësoi draftin një “puç kushtetues”, duke argumentuar se mazhoranca po shpërfillte vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe se gjyqtarët e prokurorët nuk po kërkonin një rritje të re page, por zbatimin e formulës që, sipas tij, Kuvendi kishte përcaktuar në vitin 2016.

*“Duhet të hiqet nga rendi i ditës votimi i pagave të magjistratëve. Rrezikoni të shkelni përsëri Kushtetutën. Të marrim kohën e duhur për të diskutuar me institucionet e drejtësisë”, deklaroi Bardhi.*

Edhe deputetja demokrate Jorida Tabaku kundërshtoi mënyrën se si ishte ndjekur procedura parlamentare. Ajo tha se ishte kërkuar një dëgjese me drejtuesit e institucioneve të drejtësisë, por se Komisioni i Ligjeve kishte vijuar procedurën.

*“Procesi parlamentar për miratimin e këtij ligji është shkelur. Rregullorja po ashtu. Nuk negociohet mbi Kushtetutën dhe të drejtat e tyre”, tha Tabaku. Ajo argumentoi gjithashtu se gjyqtarët kishin mbetur pa paga për dy muaj.*

Në të njëjtën linjë u shpreh edhe deputeti demokrat Oerd Bylykbashi, i cili akuzoi qeverinë për shkelje të vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe deklaroi se çështja mund të rrikthehej sërish për shqyrtim në Kushtetuese.

*“Qeveria ka shkelur vendimin e Kushtetueses. Çështja do të shkojë sërish në Kushtetuese, s’ka zgjidhje tjetër”, deklaroi Bylykbashi.*

Pavarësisht kundërshtive, kërkesa e opozitës për të hequr projektligjin nga rendi i ditës u rrëzua me **79 vota kundër**.

Nga ana tjetër, socialistët e mbrojtën projektligjin, duke argumentuar se përcaktimi i pagave është kompetencë e ligjvënësit dhe se formula e propozuar synon të zbatojë vendimin e Gjykatës Kushtetuese, duke marrë parasysh edhe mundësitë e buxhetit të shtetit.

Ministri i Drejtësisë, Ulsi Manja, deklaroi se mazhoranca nuk i ka ulur pagat e magjistratëve dhe se përplasjet e mëparshme në Gjykatën Kushtetuese, sipas tij, kanë qenë të lidhura me masën e rritjes së pagave.

*“Pavarësia financiare e sistemit të Drejtësisë është e rëndësishme, por edhe përgjegjësia e menaxhimit të financave publike është shumë e rëndësishme për Kuvendin e Shqipërisë”, tha Manja.*

Pak para votimit dhe mes kundërshtive mes opozitës dhe mazhorancës, në seancë u paraqit edhe Edi Rama.

Rama e përqendroi fjalën e tij te raportin mes pushteteve dhe roli i Gjykatës Kushtetuese. Sipas tij, Kushtetuesja mund të konstatojë shkeljen e një norme dhe ta rrëzojë atë, por nuk mund t’i diktojë Kuvendit se çfarë formule duhet të votojë.

*“Gjykata Kushtetuese është arbitri. Ajo mund ta ndalojë lojën, mund të konstatojë shkeljen, mund ta anulojë golin, por nuk mund ta marrë topin dhe të thotë: ‘Topi është imi. Penalitinë do ta gjuaj unë’”, u shpreh Rama.*

Sipas Ramës, gjithashtu se nuk mund të krijohet një sistem ku pagat e gjyqtarëve rriten automatikisht sa herë ndryshojnë pagat e kategorive të tjera dhe theksoi se është Kuvendi ai që duhet të përcaktojë normën përmes ligjit.

*“Gjykata Kushtetuese nuk na thotë dot si votojmë”, deklaroi Rama.*

Pas debatit disaorësh, projektligji i hodh në votim dhe u **miratua me 84 vota pro, 23 kundër dhe 1 abstenuim**. Formula e re parashikon rritjen e pagës referuese me rreth 8 mijë e 500 lekë, ndërsa detyrimet e prapambetura parashikohen të shlyhen me kështu.

## Artikuj te sugjeruar

POLITIKE 18 Shtator08:59

**[‘Policia u sul ndaj protestuesve si bishë e egërsuar’. Tepelena: U jemi kthyer në makth!](#)**

Për aktivistin Andi Tepelena, ajo se çfarë po ndodh me policinë në raport me protestuesit është e papranueshme, ndë...

POLITIKE 18 Shtator08:44

**[111 protesta kundër qeverisë, sot qytetarët do të mblidhen sërish në shesh përpara Kryeministrit: Rama jep dorëheqjen!](#)**

Protestuesit do të zbrisin sërish sot në shesh, ndërsa shënohet dita e 111-të e revoltës së tyre kundër kryeminis...

POLITIKE 18 Shtator07:51

**[Përplasia me magjistratët, Rama paralajmëron ligj të ri për piramidën e pagave](#)**

Kryeministri Edi Rama në fjalën e tij pas mesnate në Parlament nënara se të miratohej projektligji i Partisë Socialiste në ...

POLITIKE 18 Shtator07:41

#### **Parlamenti voton me 84 vota pro projektligjin e PS për pagat e magistratëve, PD kundër**

Parlamenti miratoi pas mesnate me 84 vota pro, 24 kundër dhe 1 abstenim projektligjin e PS-së për pagat e magistratëve, që parashiko...

POLITIKE 17 Shtator22:30

#### **“Ku janë akuzat e Dick Marty-t?”, Berisha për dënimet e krerëve të UÇK-së: Rast unikal në botë**

Kreu i PD Sali Berisha i ftuar në emisionin Opinion në Tv Klan ka komentuar vendimin e Gjykatës së Hagës për ish-krerët e U&C...

POLITIKE 17 Shtator22:13

#### **“Amerika të ndërhyjë menjëherë, rrezikohet siguria”, ish-ambasadori: Gjykata e Hagës po na trajton si plaçkë tregu**

“Gjëja shqiptare në rajon është kthyer në plaçkë tregu për fuqitë e mëdha siç ka qenë n&eu...

POLITIKE 17 Shtator22:07

#### **Pagat e gjyqtarëve/ Pak para votimit të draftit, Rama mbërrin në Kuvend**

Seanca plenare e Kuvendit vijon prej orës 10:00 të paradites, në një diskutim maratonë ku në rendin e ditës është e...

POLITIKE 17 Shtator22:07

#### **‘Gjykatë politike’/ Bushati: Rama kur mori helikopterin e dinte se po i bëhej koncension Rasisë dhe Serbisë**

Analisti Andi Bushati ka komentuar ashpër procesin ndaj ish-krerëve të UÇK-së dhe vendimin e Gjykatës Speciale në Hagë...

POLITIKE 17 Shtator22:04

#### **“Biden e dinte, por unë zgjodha gjykatën”, Berisha zbulon si u rikthye në SHBA**

Pas disa vitesh jashtë Shteteve të Bashkuara, Sali Berisha ka rrëfyer në “Opinion” përpjekjet që, sipas tij, çu...

POLITIKE 17 Shtator21:45

#### **“I djeg kësula”, Berisha vë Ramën në qendër të debatit për UÇK-në**

Në nisje të emisionit të sotëm të “Opinion”, kryedemokrati Sali Berisha u ndal te çështja më e diskutuar e...

## **ME TE VIZITUARAT**

POLITIKE 17 Shtator

#### **Tensionet te ministria e Brendshme, shoqërohet ...**

Vijojnë tensionet para Ministrisë së Brendshme. Një grup protestuesit kanë hedhur letra higjienike në drejtim të policisë&e...

SHOWBIZ 17 Shtator

#### **Susan Sarandon zbulon pse nuk u martua me Tim R...**

Susan Sarandon dhe Tim Robbins kaluan 23 vite së bashku, rritën dy fëmijë dhe për shumë kohë u konsideruan një nga &cc...

AKTUALITET 17 Shtator

#### **Këta janë tre të rinjtë nga Fieri që humbën jetë...**


Një aksident tragjik ka ndodhur në orët e para të mëngjesit në lagjen Glifadha të Athinës, ku kanë humbur jetë...

INVESTIGIME 17 Shtator17:59

#### **Tensionet te Kuvendi, shoqërohen në polici të paktën 25 protestues**

Të paktën 25 persona janë shoqëruar nga policia pas tensioneve të regjistruara gjatë protestës së zhvilluar sot pran&eum...


## **video**






E premte | ? 20:45 | ???? Syri TV





E premtë | ? 20:45 | ??? Syri TV



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.